



Titulli i projektit

Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare

Tipi i projektit

Kohezion Social/Zhvillim Ekonomik

Vendndodhja e projektit

Katund i Ri

Buxheti i paravlerësuar

250,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Zona bujqësore dhe aktivitetet në Katundin e Ri dhe në Bashkinë Durrës janë duke vuajtur nga mungesa e ekspertëve teknikë bujqësor të kualifikuar.

Në shkollën ekzistuese në Katundin e Ri organizohet mësim për nxënës të ciklit 9-vjeçar (450 nxënës) dhe të mesëm (400 nxënës). Një pjesë e madhe e nxënësve jetojnë në njësitë vendore fqinje. Një ide e mirëpritur do të ishte shtimi i një qendre trajnimi profesional të specializuar për bujqësinë në këtë shkollë.

Shkolla e mesme ekzistuese kishte fillimisht një cikël trajnimi profesional, që ofronte trajnime në bujqësi dhe në zooteknikë. Por prej shumë vitesh ky trajnim nuk ofrohet më. Duke pasur parasysh profilin bujqësor të zonës, vihet re mungesa e kuadrove të mesëm në bujqësi.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare është përmirësimi i organizimit të mësimdhënies dhe formimi i ekspertëve të bujqësisë, të cilët do t'i shërbejnë zhvillimit ekonomik të zonës.

Riprofilizimi i Shkollës së Mesme të Katundit të Ri drejt formimit profesional për zonën, e kompletuar me laboratorë dhe parcelë bujqësore eksperimentale, do të krijojë një pol zhvillimi bujqësor në Katundin e Ri që do t'i shërbejë Bashkisë Durrës dhe bashkive të tjera fqinje.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Përfitimet e këtij projekti përfshijnë:

- (a) përmirësimi i organizimit dhe cilësisë së mësimdhënies;
- (b) krijimi i ekspertëve bujqësorë të kualifikuar që do t'i shërbejnë zonës.

Nga rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare do të përfitojnë jo vetëm banorët e Katundit të Ri, por edhe ata të zonës funksionale. Numri i njësive administrative që përfitojnë nga jua ndërhyrje është 6 (gjashtë). Shkolla mund të kompletohet dhe me laboratorë dhe parcela të veçanta, që do të rrisin vlerën e shtuar të prodhimeve vendore përmes identifikimit të produkteve të përshtashme për këtë zonë.

PROJEKTI 1

program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt e projektit për rikonstruksionin fizik të ndërtesës mund të variojë nga 6-12 muaj. Aktivitetet e parashikuara përfshijnë kryerjen e punimeve të brendshme dhe të jashtme të rikonstruksionit. Parashikohet që projekti të zbatohet në periudhën e pushimeve verore ndërmjet viteve shkollore për punët që prekin mësimdhënien. Kjo bëhet për të mos ndikuar në vazhdimësinë e ciklit mësimor dhe për shkak të kushteve të favorshme të motit në këtë periudhë.

Përsa i përket fushës së kurrikulumit të ri për bujqësinë, nevojiten negociata me Ministrinë e Arsimit, ndaj duhet të parashikohet një kohë më e gjatë.

Maturimi i projektit

Parashikohet të kryhet një vlerësim i situatës së godinës së shkollës 9-vjeçare. Në bazë të këtij vlerësimi do të kryhet një llogaritje e nevojave për ndërhyrje.

Po ashtu duhet të bëhet një studim fizibiliteti për të gjithë zonën mbi koston dhe përfitimet e hapjes së kurrikulave në edukim profesional për bujqësinë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm financimi është Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, GIZ, etj..

Partnerë në zbatimin e këtij projekti mund të jenë:

- Drejtoria Rajonale Arsimore,
- Ministria e Arsimit,
- Ministria e Bujqësisë,
- Bashkia Durrës (njësia administrative Katund i Ri), etj.

Kostot e projektit

Kostoja është vlerësuar mes 250,000 dhe 500,000 EUR, në varësi të shkallës së ndërhyrjes.